

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PREZANTON RAPORTIN E VEPRIMTARISË PËRA KOMISIONIT TË LIGJEVE

Faqe 2

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë është i rëndësishëm fakti, që çdo gjyqtar dhe prokuror i Republikës e ka të qartë dhe e ndjen, se puna e tyre kontrollohet, se pretendimet ndaj punës së tyre verifikohen një më një dhe se askush nuk i ka shpëtuar hetimit, apo procedimit disiplinor, kur e ka merituar atë.



### ILD në shifra

79 vendime nga 154 praktika të trajtuara:  
55 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar  
24 vendime arkivimi pas verifikimit

25 vendime verifikimi

1 vendim për përfundim hetimi disiplinor  
për 1 magjistrat (Anëtar i KLP)  
1 kërkesë për procedim disiplinor për  
1 magjistrat (Anëtar i KLP)

1 inspektim i përfunduar:

- “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, për periudhën 1 janar 2024 – 31 dhjetor 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.”

### Qytetari në Zyrën e ILD-së

Gjatë muajit Qershor 2026:

- Janë pritur **44 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Janë realizuar **26 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- Janë trajtuar **10 kërkesa** për informacion.



Metani: Qëndrueshmëria institucionale si matës i suksesit të reformës në drejtësi

Fq. 7-8

RESIJ merr statusin e vëzhguesit pranë CEPEJ

Fq. 9-11

Rubrika/ Praktikantët flasin!

Fq. 13-15

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PREZANTON RAPORTIN E VEPRIMTARISË PARA KOMISIONIT TË LIGJEVE



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, paraqiti përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë raportin mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2025. Gjatë raportimit ai prezantoi arritjet kryesore, sfidat dhe problematikat e hasura në ushtrimin e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe iu përgjigj pyetjeve dhe interesimit të deputetëve.

### Fjala e plotë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani

*I nderuar kryetar Manja,*

*Të nderuar deputetë,*

Është kënaqësi t'i paraqes raportin komisionit, jo vetëm për elegancë të një detyrimi kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por edhe si një mundësi shumë e mirë, siç ka qenë këto 6 vite, sa herë ka raportuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të shkëmbyer mendime edhe me deputetët e nderuar, por edhe për të ndarë sugjerime apo vërejtje për punën që bëhet nga institucionet e drejtësisë. Edhe pse 15 minuta është kufiri i fjalës, mendoj që është një mundësi dhe është mundësia e vetme për të shprehur edhe mendimet që kemi në raport me punën e njëri-tjetrit, besimi që kemi tek puna e njëri-tjetrit dhe respekti që kemi për punën e njëri-tjetrit. Së dyti ju e bëtë prezantimin. Unë shoqërohem në këtë raportim nga sekretarja e përgjithshme Dëshira Pasko, por edhe znj. Pelushi, e cila u zgjodh së fundi zv/inspektore e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas 6 vitesh zyra e ka tashmë zv/inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si një detyrim ligjor që rrjedh pas plotësimit të disa kriterëve që duhet të plotësonte kandidati, kështu që doja t'juja prezantoja zv. inspektoren në këtë kapacitet.

Në paraqitjen e raportit, kam menduar të ndalem në dy aspekte kryesore: *së pari*, në nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2025 dhe masat e ndërmarra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në funksion të përmbushjes së tyre; dhe *së dyti*, në disa problematika të evidentuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale, të identifikuara përmes ankesave të qytetarëve, hetimeve disiplinore dhe inspektimeve tematike e institucionale të zhvilluara nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përgjatë vitit 2025.

Për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi ka adresuar 8 (tetë) rekomandime për vitin 2025, të cilat lidhen me forcimin e efektivitetit të inspektimeve, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, bashkëpunimin ndërinstitucional, digjitalizimin e proceseve, analizën e ankesave të qytetarëve, komunikimin publik dhe vlerësimin e ndikimit të veprimtarisë inspektuese, e cila zhvillohet nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në analizë të nivelit të zbatimit të tyre, rezulton se të gjitha rekomandimet janë përmbushur, duke u shoqëruar me masa konkrete administrative, organizative dhe rregullatore. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar akte të brendshme për monitorimin e rekomandimeve dhe raportimin me tregues të matshëm, ka parashikuar dhe planifikuar kalendarin e zhvillimit të inspektimeve vijuese, si dhe ka forcuar mekanizmat e analizës së problematikave të evidentuara nga ankesat e qytetarëve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rekomandimit për bashkëpunimin ndërinstitucional me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera, veçanërisht në funksion të aksesit në sistemet elektronike dhe zhvillimit të proceseve të digjitalizimit, duke qenë pjesëmarrës dhe proaktiv në bashkëpunimin me Këshillat dhe me Prokurorin e Përgjithshëm, në lidhje me identifikimin e nevojave dhe ofrimin e të dhënave në lidhje me aksesin e sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive. Gjithashtu janë ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe gjurmueshmërisë së proceseve të shqyrtimit të ankesave, hetimit dhe inspektimit.

E rëndësishme për t'u theksuar është se në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit është forcuar edhe *dimensioni analitik* i veprimtarisë së institucionit, përmes hartimit të raporteve mbi tematikat e ankesave, si dhe është zgjeruar veprimtaria e komunikimit publik dhe edukimit ligjor. Në të njëjtën kohë, është realizuar analiza përgjithëse e inspektimeve të kryera gjatë periudhës 2020-2025, e cila ofron një vlerësim të problematikave të evidentuara, ndikimit të rekomandimeve dhe nevojave për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me gjendjen e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor gjatë kësaj periudhe kohore.

Pra, rekomandimet e lëna nga Kuvendi, jo vetëm që janë përmbushur nga Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por edhe kanë prodhuar përmirësime në procese pune, të cilat nxjerrin më në pah veprimtarinë e ILD-së.

Në këndvështrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky raport nuk përbën vetëm një pasqyrë të treguesve sasiorë të veprimtarisë së institucionit, por edhe një mundësi për të vlerësuar funksionimin jo vetëm të mekanizmave të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, por edhe efektivitetin, apo cilësinë e funksionimit të pushtetit gjyqësor sot në Shqipëri. Në këtë kuptim, vlerësimi i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2025, mendoj se mund dhe duhet të shkojë përtej numrit të ankesave të trajtuara, inspektimeve të zhvilluara, hetimeve, procedimeve disiplinore të filluara, apo masave disiplinore të dhëna ndaj magjistratëve. Edhe pse, edhe në këtë aspekt, puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë edhe këtë vit ka rezultate.

Gjatë vitit 2025 janë administruar gjithsej 3.272 ankesa, (1792 të reja dhe 1480 të mbartura), gjysma e të cilave janë shqyrtuar gjatë vitit raportues 2025. Vetëm gjatë vitit 2025 janë trajtuar 1635 ankesa. Numri i ankesave të trajtuara është i lartë, duke treguar se mekanizmi i verifikimit të ankesave dhe të verifikimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve funksionon. Këtu mund të ketë edhe një pikëpyetje apo shqetësim, se numri i ankesave të trajtuara është shumë i lartë, në raport me numrin e zhvillimit të hetimeve disiplinore, apo kërkesave për procedim disiplinor. Por, siç e kam theksuar edhe herë tjetër përpara këtij komisioni, raporti ndërmjet numrit të ankesave të trajtuara dhe hetimeve (12), apo procedimeve disiplinore (8), nuk përbën në vetvete një tregues të mosfunksionimit të procesit disiplinor të magjistratëve. Përkundrazi, ky raport evidenton në mënyrë të qartë, se trajtimi i ankesave funksionon më së miri, si një mekanizëm filtrues, apo fazë paraprake e shqyrtimit të pretendimeve ndaj veprimtarisë së magjistratëve, e cila synon të diferencojë ankesat e pabazuara, nga ato që përmbajnë elementë të mjaftueshëm faktikë dhe juridikë për fillimin e hetimit, apo procedimit disiplinor.

Por, siç e kam theksuar edhe herë tjetër përpara këtij komisioni, raporti ndërmjet numrit të ankesave të trajtuara dhe hetimeve (12), apo procedimeve disiplinore (8), nuk përbën në vetvete një tregues të mosfunksionimit të procesit disiplinor të magjistratëve. Përkundrazi, ky raport evidenton në mënyrë të qartë, se trajtimi i ankesave funksionon më së miri, si një mekanizëm filtrues, apo fazë paraprake e shqyrtimit të pretendimeve ndaj veprimtarisë së magjistratëve, e cila synon të diferencojë ankesat e pabazuara, nga ato që përmbajnë elementë të mjaftueshëm faktikë dhe juridikë për fillimin e hetimit, apo procedimit disiplinor. Shqyrtimi dhe verifikimeve i pretendimeve për rreth 1650 praktika pune të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u shprehur me vendim të plotë dhe të arsyetuar për këto pretendime, tregojnë se magjistratët e ndjejnë peshën e verifikimit të punës së tyre, në përputhje me protokollin kushtetues dhe ligjin. Është e rëndësishme të theksoj këtu, se hetimi dhe procedimi disiplinor nuk janë emocione të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por janë standarde të ndjekura nga dita e 1 (një) e punës, duke ruajtur të njëjtin parim të të punuarit, me verifikimin e pretendimeve ndaj punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, në këtë rast vlen të theksohet se standartet e vendosura në ligj për hetimin apo provueshmërinë përgjatë zhvillimit të hetimit apo procedimit disiplinor janë shumë të larta, me qëllim garantimin e të drejtave dhe pavarësisë së magjistratëve. Pra, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë është i rëndësishëm fakti, që çdo gjyqtar dhe prokuror i Republikës e ka të qartë dhe e ndjen, se puna e tyre kontrollohet, se pretendimet ndaj punës së tyre verifikohen një më një, dhe se askush nuk i ka shpëtuar hetimit, apo procedimit disiplinor, kur e ka merituar atë. Por nga ana tjetër, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton protokollin kushtetues, jo si pamundësi, apo si dëshirë për të shmangur nga përgjegjësia magjistratët, por si standard, që ligjëvënësia në Shqipëri, por kudo në botën demokratike ka vendosur, për të ruajtur një balancë të drejtë midis pavarësisë dhe përgjegjësisë. Të dhënat tregojnë se sot e 6 vjet, që prej krijimit të kësaj zyre, për rreth 8000 ankesa të trajtuara nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, institucionet që verifikojnë vendimmarrjet e ILD-së, si Këshillat, KPA, apo edhe GJEDNJ, nuk kanë gjetur në asnjë rast, që verifikimi i ankesave apo hetimet e kryera nga ILD, të jenë të paplota, jo profesionale apo me standarde të dyfishta. Sepse, në këndvështrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zbatim i rigorozisht i standardeve kushtetuese dhe jo i mendimeve personale profesionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është e vetmja mënyrë për të ngritur një sistem drejtësie të pavarur. Mendoj se ky është kontributi më i mirë, që mund të japë një institucion si Inspektori i Lartë të Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, në këtë aspekt vlen të theksohet se dhe analiza në lidhje me masat disiplinore të propozuara nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo të vendosura nga ana e Këshillave, duhet të analizohen apo vlerësohen në frymën e parimit të proporcionalitetit. Masat disiplinore ndaj magjistratëve në radhë të parë kanë për qëllim parandalimin dhe edukimin e magjistratëve dhe jo domosdoshmërisht ndëshkimin maksimal të tyre. Propozimi i një masë disiplinore nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bazohet gjithnjë, jo vetëm në kritere objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore, por edhe mbi baza të individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer. Për këtë arsye, aplikimi i masave disiplinore më të rënda, nuk është tregues se mekanizmi disiplinor funksionon në mënyrë më të drejtë, apo është më efektiv.

Në analizë të objektit të ankesave, rezultojnë se shqetësimet kryesore të qytetarëve lidhen me kohëzgjatjen e gjykimeve tej afateve të arsyeshme, zvarritjen e veprimeve hetimore dhe vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Pretendimet në lidhje me vendimmarrje të padrejtë nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve, mbetën një numër i konsiderueshëm i pretendimeve të paraqitura nga ana e qytetarëve, edhe përgjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2025, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë depozituar 1792 ankesa. Nga këto: (i) 255 ankesa janë për zvarritje të gjykimit të çështjes ose 14% e totalit të ankesave të hyra në 2025; (ii) 159 ankesa janë për zvarritje të hetimit ose 9% e totalit të ankesave të hyra në 2025; (iii) 462 ankesa janë për vendimmarrje të padrejtë ose 26% e totalit të ankesave të hyra në 2025; si dhe (iv) 110 ankesa janë për vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore ose 6% e totalit të ankesave të hyra në 2025.

Një tjetër problematikë me të cilën po ballafaqohen qytetarët sot, është mënyra e zhvillimit të seancave gjyqësore, në kushtet e mungesës së infrastrukturës së nevojshme jo vetëm infrastrukturorë, por edhe për respektimin e kërkesave procedurale për zhvillimin e gjykimit me regjistrim audio. Ndërkohë, duke marrë shkas nga disa ankesa, të cilat i janë nënshtruar verifikimit gjatë vitit 2025, por edhe informacionit të paraqitur nga vetë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një problematikë e sistemit gjyqësor, sot është produktiviteti dhe efektiviteti i magjistratëve në planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive gjyqësore. Në të njëjtën kohë, edhe respektimi i rregullave të etikës dhe solemnitetit është në fokus të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këto të dhëna kanë rëndësi të veçantë, pasi tregojnë se perceptimi publik mbi sistemin e drejtësisë nuk lidhet vetëm me sjelljen individuale të magjistratëve, por edhe me problematika më të gjera të funksionimit të sistemit të drejtësisë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre problematikave kanë karakter strukturor dhe tejkalojnë përgjegjësinë individuale disiplinore të magjistratëve. Për këtë arsye, vlerësoj se mekanizmi disiplinor nuk mund të zëvendësojë politikën e përgjithshme të administrimit të pushtetit gjyqësor, menaxhimin e burimeve njerëzore, financimin e sistemit të drejtësisë apo ndërhyrjet me karakter sistemik. Në këtë aspekt, Inspektorit i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të ushtrorë një rol të rëndësishëm, jo vetëm si mekanizëm i trajtimit të ankesave të qytetarëve, por dhe si institucion evidentues i problematikave me karakter sistemik të pushtetit gjyqësor.

Dhe në vijim të këtij vizioni strategjik, gjatë vitit 2025, veprimtaria inspektuese e gjykatave dhe zyrave të prokurorive me karakter tematik apo institucional ka zënë një vend të rëndësishëm, në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Përzgjedhja e tematikave të këtyre inspektimeve është realizuar mbi bazën e një analize të kujdesshme të burimeve të ndryshme të informacionit, të cilat kanë shërbyer për identifikimin e problematikave dhe prioriteteve në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë objektet e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), informacionet periodike të përcjella nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive, si dhe propozimet apo informacionet e ardhura nga institucione të tjera publike.

Këto inspektime kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në evidentimin dhe analizimin e problematikave që lidhen me funksionimin e organeve të drejtësisë, por edhe në forcimin e mekanizmave të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies. Në rastet kur gjatë procesit të inspektimit janë konstatuar elemente të shkeljeve disiplinore, janë iniciuar hetime disiplinore përkatëse dhe, kur janë plotësuar kushtet ligjore, janë nisur edhe procedime disiplinore ndaj magjistratëve. Në këtë mënyrë, inspektimi tematik/institucional ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm për garantimin e respektimit të standardeve profesionale dhe etike, si dhe për rritjen e integritetit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

Për 7 (shtatë) inspektime të kryera gjatë vitit 2025 janë hartuar gjithsej 75 rekomandime, prej të cilave, 14 lidhen me nevojën për ndërhyrje normative apo rregullatore, 46 kanë karakter administrativ dhe 15 janë adresuar për vetë institucionin. Kjo strukturë e rekomandimeve dëshmon qartë se funksioni inspektues i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po evoluon gradualisht nga një model tradicional kontrolli individual të magjistratëve drejt një funksioni më të gjerë analitik të problematikave me karakter sistemik të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, dëshiroj të ndaj me ju se analiza e efektivitetit të këtyre rekomandimeve është një proces, i cili kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Brenda zyrës së ILD-së, kjo është një çështje në diskutim të përditshëm me trupën e inspektorëve dhe shërbimet juridike, por edhe me partnerë ndërkombëtarë, që asistojnë zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për ta bërë sa më funksionale dhe performuese, këtë kompetencë thelbësore të ILD-së. Por, mendoj se analiza e efektivitetit të rekomandimeve të ILD-së, lidhet dhe me faktorë dhe aktorë të tjerë. Së pari, reformat në sektorin e drejtësisë, ndërhyrjet strukturorë konsiderohen dhe janë procese afatgjata, të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për t'u implementuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Së dyti, procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon kohë, si dhe efektiviteti i tyre varet nga niveli i zbatimit prej institucioneve përgjegjëse, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Shkollën e Magjistraturës, apo drejtuesit e institucioneve dhe administratën gjyqësore. Së treti, është thelbësore nevoja për një qasje të koordinuar dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, vizioni afatgjatë dhe planifikimi strategjik ndërmjet organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Së katërti, në një sistem drejtësie, i cili po zhvillohet dita-ditës dhe problematikave me karakter sistemik janë të shumta, mungojnë ende indikatorë të matshëm (sasiorë/cilësore), që të mundësojnë vlerësimin e ndikimit konkret të rekomandimeve në uljen e vonesave, përmirësimin e performancës, apo reduktimin e problematikave të përsëritura në lidhje me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor.

Por, pavarësisht ekzistencës së këtyre faktorëve, një pjesë e konsiderueshme e vlerësimit të rezultateve janë në nivel gjurmueshmërie dhe analize të vazhdueshme nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet zhvillimit të inspektimeve vijuese me qëllim monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Në këtë drejtim, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po punohet për hartimin e një metodologjie të posaçme në lidhje me monitorimin dhe ndjekjes e procesit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kuadër të zhvillimit të inspektimeve tematike/institucionale.

### ***Të nderuar zotërinj deputetë!***

Në vijim të këtij raportimi, dëshiroj të paraqes disa nga problematikat kryesore apo çështje me rëndësi, të cilat edhe gjatë vitit 2025, kanë vijuar të ndikojnë në funksionimin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Këto çështje përfshijnë aspekte strukturore, procedurale dhe institucionale, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë dhe adresim të koordinuar ndërmjet organeve përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e standardeve të drejtësisë dhe rritjen e besimit të publikut në institucionet e saj.

*Së pari*, një nga masat që ka patur ndikim të drejtpërdrejtë në aksesin e individëve në sistemin e drejtësisë është dhe riorganizimi i gjykatave në kuadër të hartës gjyqësore. KLGJ-ja ka detyrën të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme pasojat dhe efektet e këtij riorganizimi, duke analizuar nëse kjo hartë i ka arritur objektivat për të cilat është miratuar dhe në veçanti, sa është garantuar e drejta e aksesit në drejtësi, sa është rritur eficaenca e shërbimeve të ofruara për palët dhe cili ka qenë efekti që ka patur në trupën gjyqësore. Vetëm një analizë e tillë mund të përbëjë një argument të nevojshëm, për mundësinë e riformatimit të hartës gjyqësore edhe në një afat më të shpejtë, nëse kjo konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme. Përveç kësaj analize, një riorganizim tjetër duhet të shoqërohet me një vlerësim paraprak dhe një garantim të kushteve të nevojshme infrastrukturore, administrative dhe funksionale përpara fillimit të efekteve të tij.

*Së dyti*, respektimi i rregullave të solemnitetit, komunikimit dhe sjelljes së magjistratëve në marrëdhënie me eprorët, palët pjesëmarrëse dhe kolegët përbën një problematikë tjetër të evidentuar në përmbajtjen e ankesave, por edhe nga verifikimet e iniciuara kryesisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Këshillat, në këto raste, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme në lidhje me caktimin ose jo të masave disiplinore të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në lidhje me respektimin e etikës dhe të solemnitetit në gjykim apo veprimtarinë hetimore, duhet të kenë rol më aktiv nëpërmjet marrjes së masave konkrete për analizimin e këtyre rasteve nga Këshilltari i Etikës dhe dhënien e orientimeve mbi mënyrën e veprimit dhe sjelljes së magjistratëve për fenomene të ngjashme.

Në veçanti vlerësohet, se Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të miratojë instrumentet e nevojshme, të cilat të udhëzojnë modelin e sjelljes që duhet të ndjekin magjistratët në rast të dilemave etike, nëpërmjet opinioneve përkatëse për t'i paraprirë shkeljeve të mundshme të etikës nga prokurorët. Është e rëndësishme të evidentohet se procedura disiplinore duhet të jetë mekanizmi i fundit korrigjues për respektimin e etikës nga magjistrati. Nga ana tjetër, duhet të forcohet bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në trajnimin vazhdues të magjistratëve, veçanërisht atyre me më pak vite përvojë në sistem, në kuadër të shpeshimit të trajnimeve dhe individualizimit të tyre për rastet e referuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Njëkohësisht, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe trajnimit vazhdues të magjistratëve të tjerë, në përgatitjen e tematikave me efekt ndërgjegjësuës dhe parandalues për shmangien e sjelljeve, të cilat mund të kenë ndikim serioz në perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

*Së treti*, krahas qytetarëve, pretendime lidhur me vendimmarrje të gabuara nga ana e magjistratëve paraqiten në mënyrë të vazhdueshme edhe nga institucionet shtetërore. Vlen të ndalemi edhe tek institucionet, që për shkak të kompetencave të akorduara nga kuadri ligjor, duhet të paraqesin ankesa, të cilat të parashtrajnë të dhëna të besueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore, siç është rasti i Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesve të zyrave të prokurorisë apo kryetarëve të gjykatave. Në shumë raste, faktet e paraqitura nga këto institucione kanë shërbyer si shkak për nisjen e hetimeve disiplinore dhe pasi i janë nënshtruar procesit të hetimit disiplinor, kanë përfunduar me propozime për masa disiplinore ndaj magjistratëve.

Në procedimet disiplinore të kryera, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është mbështetur në standardin sipas të cilit, jo çdo ndryshim apo prishje e një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të përbëjë apriori shkak ligjor të mjaftueshëm për procedimin disiplinor të magjistratit, nëse nuk evidentohet që vendimmarrja të ketë qenë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin, apo me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë sjellë diskreditimin e pozitës dhe figurës së magjistratit. Në rastet kur ankesat e paraqitura nga institucionet janë arkivuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas verifikimit të tyre, ka vlerësuar se pretendimet institucionale zgjidhen nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të kontrollit gjyqësor dhe se në ushtrimin e diskrecionit nga magjistratët në zbatimin dhe interpretimin e kuadrit ligjor nuk janë konstatuar elemente të shkeljeve disiplinore.

Në të njëjtën kohë, në këtë aspekt, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet të marrë masa për zgjidhjen e konflikteve, shmangien e divergjencave dhe qëndrueshmërinë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Procesi i ndryshimit dhe njehsimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë dhe detyrimi i gjykatave të zakonshme për të zbatuar vendimet nomofilatike, nga ana tjetër, i shërbejnë vlerave të uniformitetit dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë, duke vlerësuar qëndrimet apo interpretimet e ndryshme të mbajtura nga gjykatat më të ulëta, duhet të adresojë nevojën për siguri juridike, duke ushtruar funksionin e saj kushtetues në kuadër të harmonizimit të së drejtës dhe të koherencës së orientimeve jurisprudenciale.

*Së katërti*, në përmbyllje, dëshiroj të theksoj se forcimi i sistemit të drejtësisë nuk mund të arrihet pa një bashkërendim të qëndrueshëm dhe funksional ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse. Bashkëveprimi dhe koordinimi ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i nevojshëm, në fushat me ndikim në veprimtarinë e magjistratëve dhe në veçanti në paraqitjen e propozimeve për kryerjen e inspektimeve tematike. Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë i angazhuar dhe vijon të ofrojë angazhim maksimal, në kuadër të zhvillimit të një kulture bashkëpunimi dhe koordinimi institucional, ku të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës, apo dhe organet e tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, të punojnë mbi plane veprimi strategjik të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Ky proces kërkon vizion afatgjatë, plan të strukturuar zbatimi dhe një vlerësim të vazhdueshëm të rezultateve, në mënyrë që çdo rekomandim të shndërrohet në realitet institucional. Vetëm përmes bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët, mund të garantojmë një sistem drejtësie, që i shërben qytetarit dhe që mund të funksionojë mbi themele të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe besueshmërie.

Në përfundim të këtij raportimi, dua të sjell në vëmendje të Kuvendit të Shqipërisë, se të gjitha çështjet e trajtuara tregojnë se sistemi i drejtësisë ndodhet përpara sfidave të rëndësishme strukturore dhe me karakter sistematik, të cilat kërkojnë një qasje të integruar dhe të koordinuar ndërinstitucionale.

Përmirësimi i kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, rritja e efikasitetit të hetimeve, forcimi i infrastrukturës institucionale, garantimi i standardeve të të drejtave të njeriut dhe unifikimi i praktikës gjyqësore përbëjnë elementë thelbësorë të një sistemi drejtësie funksional dhe të besueshëm për qytetarët shqiptar. Në këtë kuadër, balancimi mes pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, si dhe forcimi i etikës profesionale janë shtylla të domosdoshme për konsolidimin e shtetit të së drejtës. Vetëm përmes një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërinstitucional dhe një vizioni të përbashkët reformues mund të garantohet një drejtësi më efikase, më transparente dhe më e afërt me standardet evropiane dhe pritshmëritë e qytetarëve.

Faleminderit për vëmendjen dhe mbetëm në dispozicion për çdo pyetje apo diskutim lidhur me veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2025.



## METANI: QËNDRUESHMËRIA INSTITUCIONALE SI MATËS I SUKSESIT TË REFORMËS NË DREJTËSI



***Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z.Artur Metani në ceremoninë përmbyllëse të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.***

I nderuar z. Çomo!

Të nderuar pjesëmarrës,

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë që më dhatë për të shprehur disa mendime, në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Edhe pse një proces i pazakontë dhe tronditës për sistemin, vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve erdhi si një imperativ i kohës, për të adresuar mosbesimin e thellë dhe të përhapur të publikut ndaj sistemit të drejtësisë, perceptimin e lartë të korrupsionit në gjyqësor dhe korporatizmin në sistem. Në këtë drejtim, anëtarët e organeve të vettingut dhe ONM kanë kryer një punë të jashtëzakonshme, duke verifikuar dhe larguar nga sistemi pjesën e pashëndetshme të tij, mbi bazën e standardeve konkrete të vlerësimit të integritetit të gjyqtarëve e prokurorëve. Sot sistemi i drejtësisë, edhe për shkak të kësaj pune, është dukshëm më i mirë sesa ai i periudhës para vitit 2016.

Tanimë, përfundimi i procesit të vettingut kërkon një vlerësim të kujdesshëm dhe një reflektim mbi të ardhmen, pasi shënon kalimin nga faza e funksionimit të mekanizmit të jashtëzakonshëm të vettingut dhe sui generis, të kontrollit të integritetit dhe profesionalizmit të magjistratëve, drejt një etape të re, ku përgjegjësia për garantimin e integritetit dhe profesionalizmit të magjistratëve u takon plotësisht institucioneve të reja të drejtësisë.

Kjo është arsyeja pse përfundimi i këtij procesi nuk duhet parë si finalizimi, apo arritja e rezultateve të duhura dhe të suksesshme të rrugëtimit të reformës në drejtësi. Ky moment shënon fillimin e fazës më të rëndësishme të reformës në drejtësi, i cili ka të bëjë me institucionalizimin e standardeve të integritetit dhe të përgjegjshmërisë. Sfidat tashmë, nuk është më pastrimi i sistemit të drejtësisë nga magjistratët jo profesionistë, jo me integritet, apo të papërgjegjshëm, por garantimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë mbi baza apo standarde të qëndrueshme profesionalizmi, etike dhe përgjegjshmërie.

Pikërisht sot, ne duhet të shkojmë një hap më përpara drejt një sistemi drejtësie, i cili funksionon në kushte normale. Një shtet i së drejtës nuk mund të mbështetet pafundësisht mbi masa të jashtëzakonshme. Kur masat e jashtëzakonshme kanë karakter vazhdues apo të përhershëm, ato rrezikojnë të bien në kundërshtim me vetë parimet që synojnë të mbrojnë. Për këtë arsye, dilema që duhet ti japim përgjigje sot nuk është nëse standardet e vettingut duhet të vazhdojnë apo jo, por nëse këto standarde janë bërë pjesë e veprimtarisë së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë për të garantuar në të ardhmen integritetin dhe llogaridhënien e magjistratëve.

Sfida e sotme e të gjithëve ne është ndërtimi i një sistemi drejtësie të ri, të qëndrueshëm si dhe duke u organizuar dhe funksionuar mbi bazën e një sistemi "llogaridhënës të zakonshëm". Nëse do të gjykojmë një ditë suksesin e reformës në drejtësi, treguesi më domethënës nuk do të jetë thjesht numri i çështjeve të trajtuara nga organet e vettingut, apo vendimet individuale të marra prej tyre, por aftësia e institucioneve të reja dhe të përhershme për të ruajtur dhe zhvilluar vetë standardet e integritetit, profesionalizmit dhe llogaridhënies që procesi i vettingut synoi të vendoste.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Vetëm atëherë mund të themi se standardet e jashtëzakonshme me karakter kalimtar kanë përmbushur misionin e tyre për të cilin u krijuan dhe, jo duke zëvendësuar institucionet aktuale, por duke krijuar kushtet që këto institucione të funksionojnë në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

Për këtë arsye, fokusi i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë duhet të mbetet tek profesionalizimi, paanshmëria, transparencja dhe pavarësia në ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese. Në këtë drejtim, po aq e rëndësishme është edhe ndërtimi i një praktike të qëndrueshme dhe të parashikueshme administrative institucionale. Vendimet e arsyetuara, procedurat e qarta dhe standardet e konsoliduara ligjore jo vetëm që forcojnë sigurinë juridike të veprimtarisë institucionale, por kontribuojnë gjithashtu edhe në krijimin e një kulture të përgjegjshmërisë profesionale.

Në këtë proces, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është i vetmi institucion që duhet të luajë një rol të rëndësishëm. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë luajnë një rol po aq të rëndësishëm në garantimin e meritokracisë, zhvillimit të karrierës dhe funksionimit efektiv të mekanizmave të përgjegjshmërisë. Ndërsa Shkolla e Magjistraturës mbetet institucioni kyç ku formësohen jo vetëm njohuritë profesionale,

por edhe kultura etike e brezave të ardhshëm të magjistratëve, pasi integriteti i tyre nuk mund të sigurohet vetëm nëpërmjet aplikimit të mekanizmave të kontrollit dhe përgjegjësisë.

Integriteti dhe profesionalizimi i magjistratëve duhet të shndërrohet në një kulturë institucionale dhe duhet të funksionjë mbi bazën e një sistemi efektiv përgjegjshmërie. Dhe kjo kulturë duhet të ndërtohet në mënyrë të vazhdueshme dita-ditës përmes kombinimit të edukimit profesional, vetëdijes etike të magjistratëve, sistemit të karrierës dhe sistemeve efektive të llogaridhënies.

Në të njëjtën kohë, duhet të tregohet një kujdes i shtuar dhe maturi në ruajtjen e një ekuilibri delikat ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies së magjistratëve. Pavarësia e magjistratëve nuk është një privilegj personal i tyre, por ajo është një garanci kushtetuese për qytetarin. Por po aq e vërtetë është se pavarësia nuk mund të ekzistojë pa një sistem llogaridhënës. Sfidat e institucioneve të reja është pikërisht ruajtja e këtij ekuilibri, në mënyrë që llogaridhënia të mos cenohet pavarësinë dhe pavarësia të mos shndërrohet në mungesë përgjegjshmërie apo përgjegjësie.

**Ju faleminderit!**

*Fjala e plotë në ceremoninë përmbyllëse të vettingut*



## RESIJ MERR STATUSIN E VËZHGESIT PRANË CEPEJ



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani mori pjesë në punimet e Asamblesë së 46-të të Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ), të zhvilluar në Shibenik të Kroacisë.

I mandatuar nga Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) për të paraqitur zyrtarisht aplikimin për marrjen e statusit të vëzhguesit pranë CEPEJ-it, z. Metani iu drejtua Asamblesë duke vënë në pah ekspertizën dhe kontributin e deritanishëm të Rrjetit në fushën e inspektimit të drejtësisë.

*“Në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Këshillin e Evropës dhe CEPEJ-in që prej vitit 2020, kam pasur mundësinë të njoh nga afër nivelin e lartë të ekspertizës që ky komision ofron në fusha të ndryshme të administrimit dhe vlerësimit të drejtësisë. Njëkohësisht, besoj se RESIJ mund të sjellë një vlerë të shtuar në një fushë tepër specifike dhe të specializuar në CEPEJ”, u shpreh ai.*

Z. Metani nënvizoi se shërbimet e inspektimit që përbëjnë RESIJ kanë në qendër të veprimtarisë së tyre vlerësimin e funksionimit të gjykatave dhe prokurorive, inspektimin e veprimtarisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe identifikimin e mekanizmave që kontribuojnë në integritetin, efikasitetin dhe cilësinë e sistemit gjyqësor. Ai theksoi se një sistem drejtësie efikas nuk mund të vlerësohet vetëm përmes statistikave, treguesve të produktivitetit apo kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, pasi këta indikatorë, ndonëse të rëndësishëm, jo gjithmonë arrijnë të zbulojnë shkaqet reale të problematikave që ndikojnë në funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe as të pasqyrojnë plotësisht cilësinë e drejtësisë që u ofrohet qytetarëve.

*“Në vendet tona përkatëse, strukturat e inspektimit luajnë një rol të pazëvendësueshëm. Ato ndihmojnë në identifikimin e mangësive sistemike, vonesave procedurale, sfidave organizative dhe rreziqeve që mund të cenojnë funksionimin e pushtetit gjyqësor. Veçanërisht në vendet që po kalojnë reforma të thella në sistemin e drejtësisë, shërbimet e inspektimit mund të luajnë një rol kyç në garantimin e stabilitetit institucional, koherencës dhe vazhdimësisë së standardeve profesionale”, deklaroi ai.*

Gjatë fjalës së tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndau edhe një moment personal, lidhur me mbështetjen që CEPEJ dhe Këshilli i Evropës i kanë dhënë institucionit që ai drejton.

*“Kontakti i parë i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë me RESIJ u bë i mundur pikërisht falë mbështetjes së CEPEJ-it. Në qershor të vitit 2021, CEPEJ mundësoi vendosjen e kontaktit ndërmjet ILD-së dhe Inspektoratit Francez, i cili në atë kohë mbante presidencën e RESIJ-it, si dhe përcolli interesin e ILD-së për t’u bërë pjesë e këtij rrjeti”, tha ai.*

Z. Metani kujtoi se në dhjetor 2021 RESIJ e pranoi ILD-në me status vëzhguesi, ndërsa në tetor 2023, duke vlerësuar angazhimin aktiv dhe kontributin e Shqipërisë në kuadër të rrjetit, i akordoi Inspektorit të Lartë të Drejtësisë statusin e anëtarit me të drejta të plota.

*“Sot jam para jush në emër të RESIJ-it dhe kam privilegjin të paraqes para kësaj Asambleje kërkesën për t’i dhënë Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë statusin e vëzhguesit pranë CEPEJ-it, me bindjen se ky bashkëpunim do të sjellë vlera të shtuara për të dy institucionet dhe për komunitetin evropian të drejtësisë në tërësi”, tha z. Metani.*

Aplikimi i RESIJ-it për marrjen e statusit të vëzhguesit u miratua unanimitisht nga Asambleja e 46-të e CEPEJ-it.

*“Urime, zoti Metani! Urime Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë për marrjen e statusit të vëzhguesit. Mirë se erdhët në familjen e madhe të CEPEJ-it. Jemi të lumtur të vazhdojmë të punojmë me shumë kënaqësi me ju”, deklaroi Presidenti i CEPEJ-it, Francesco Depascale, në përfundim të votimit.*

**FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, ARTUR METANI**

**NË ASAMBLENË E 46-TË PLENARE TË CEPEJ**

**18-19 Qershor 2026**

**Shibenik, Kroaci**

*I nderuar Z. President Depasquale,*

*E nderuar Znj. Decot,*

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Para së gjithash, dëshiroj t'ju falënderoj për ftesën dhe për organizimin e këtij eventi të shkëlqyer.

Emri im është Artur Metani dhe shërbej si Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë. Është një kënaqësi dhe një nder të marr pjesë në këtë Asamble dhe t'ju drejtohem në emër të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ).

Ju përcjell përshëndetjet e Presidentit të RESIJ, z. Stéphane Noël, i cili për fat të keq nuk mundi të ishte me ne sot, si dhe përshëndetjet e të gjithë kolegëve të mi brenda Rrjetit.

RESIJ është një shoqatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 2017. Misioni i saj kryesor është të bashkojë shërbimet e inspektimit gjyqësor të Shteteve Anëtare dhe Vendeve Kandidate të Bashkimit Evropian, me qëllim promovimin e shkëmbimit të metodologjive dhe praktikave më të mira, zhvillimin e studimeve dhe misioneve të përbashkëta, si dhe kontributin në përmirësimin e sistemeve të drejtësisë.

Sot, RESIJ përbëhet nga nëntë anëtarë: Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Spanja, Franca, Italia, Moldavia, Portugalia dhe Rumania.

Veprimtaritë e Rrjetit përqendrohen në disa objektiva themelore: zhvillimin e standardeve të përbashkëta për vlerësimin e funksionimit dhe performancës së sistemeve gjyqësore; identifikimin dhe promovimin e garancive të përbashkëta në fushat e etikës dhe kompetencës profesionale; shkëmbimin e praktikave më të mira dhe ofrimin e ekspertizës së specializuar; si dhe formulimin dhe komunikimin e rekomandimeve dhe propozimeve konkrete për institucionet e Bashkimit Evropian dhe për organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e drejtësisë.

Që nga themelimi i tij, RESIJ ka zhvilluar marrëdhënie të ngushta dhe produktive me CEPEJ. Nën kujdesin e CEPEJ dhe në kuadër të Programit Jugor të Këshillit të Evropës, Rrjeti ynë ka marrë pjesë aktivisht në shkëmbime dhe aktivitete të përbashkëta me ARNJIS, (Rrjetin Arab të Shërbimeve të Inspektimit Gjyqësor). Aktualisht po finalizojmë një protokoll zyrtar bashkëpunimi, i cili do të institucionalizojë marrëdhëniet ndërmjet dy rrjeteve tona dhe do të krijojë një kuadër të qëndrueshëm për bashkëpunim afatgjatë.

RESIJ ka realizuar gjithashtu me sukses misionet e përbashkëta me disa shërbime evropiane të inspektimit gjyqësor, duke kontribuar në nisja të rëndësishme ndërkombëtare.

Këto përfshijnë projekte mbi vlerësimin e drejtësisë civile evropiane, mbrojtjen e të rriturve vulnerabël dhe, së fundmi, projektin COPEIJ të financuar nga Komisioni Evropian "Bashkëpunimi në Mbrojtjen e Mjedisit përmes Autoriteteve Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë". Gjatë një periudhe dyvjeçare, kjo nismë bashkoi pesë shërbime inspektimi nga vendet anëtare të RESIJ: Franca, Italia, Portugalia, Rumania dhe Shqipëria.

Në dhjetor 2023, RESIJ publikoi studimin e tij të parë krahasues mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit gjyqësor në vendet anëtare. Ky studim përditësohet dhe zgjerohet vazhdimisht për të adresuar sfidat dhe prioritetet në zhvillim me të cilat përballen sistemet evropiane të drejtësisë. Ndër temat që aktualisht po trajtohen janë përdorimi i inteligjencës artificiale në administrimin e drejtësisë, forcimi i integritetit institucional dhe parandalimi i korrupsionit brenda gjyqësorit.

Këto iniciativa demonstrojnë angazhimin e vazhdueshëm të RESIJ për modernizimin, transparencën dhe efektivitetin e sistemeve të drejtësisë, duke forcuar njëkohësisht bashkëpunimin evropian në shërbim të një sistemi drejtësie me cilësi më të lartë dhe më të besueshëm për qytetarët.

Në planin personal, jam veçanërisht i kënaqur që ndodhem sot këtu duke përfaqësuar RESIJ. Kontakti i parë ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë dhe RESIJ u bë i mundur falë mbështetjes së CEPEJ. Në qershor 2021, CEPEJ lehtësoi kontaktin ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit Francez, i cili në atë kohë mbante presidencën e RESIJ, dhe përcolli interesin e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Rrjetit.

Sot, në cilësinë time si Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë, kam privilegjin të paraqes përpara kësaj Asambleje të nderuar, në emër të RESIJ, kërkesën tonë për t'i dhënë Rrjetit statusin e vëzhguesit pranë CEPEJ. Ne besojmë fuqimisht se ky bashkëpunim do të sjellë vlerë të shtuar të rëndësishme si për të dy institucionet, ashtu edhe për komunitetin evropian të drejtësisë në tërësi.

Duke marrë parasysh kontributin afatgjatë të CEPEJ në përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe funksionimit të sistemeve gjyqësore në mbarë Evropën, si dhe gatishmërinë tonë për të ndarë në mënyrë të strukturuar studimet, përvojën dhe ekspertizën tonë profesionale, RESIJ do ta konsideronte dhënien e statusit të vëzhguesit si një nder të madh. Jemi të bindur se një status i tillë do të shërbente si një urë e rëndësishme për bashkëpunimin institucional në ndjekje të objektivave tona të përbashkëta: një sistem drejtësie më efikas, më transparent, me cilësi më të lartë dhe më llogaridhënës ndaj qytetarëve.

Si Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë, dhe falë bashkëpunimit të vazhdueshëm të vendosur që nga viti 2020 me Këshillin e Evropës dhe CEPEJ, kam pasur mundësinë të njoh nga afër nivelin e lartë të ekspertizës që ky Komision ofron në fusha të shumta të administrimit dhe vlerësimit të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, besoj se RESIJ mund të ofrojë vlerë të shtuar plotësuese në një fushë shumë të specializuar që ende nuk përfaqësohet plotësisht brenda kuadrit të CEPEJ: inspektimi gjyqësor.

Shërbimet e inspektimit që përbëjnë Rrjetin tonë vendosin në qendër të veprimtarisë së tyre të përditshme vlerësimin e funksionimit të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, inspektimin e veprimtarisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe identifikimin e mekanizmave që forcojnë integritetin, efikasitetin dhe cilësinë e sistemeve gjyqësore. Kjo ekspertizë pasurohet vazhdimisht përmes shkëmbimeve të rregullta ndërmjet anëtarëve të Rrjetit dhe përmes bashkëpunimit me homologët evropianë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një sistem drejtësie efikas nuk mund të matet vetëm përmes statistikave, treguesve të produktivitetit apo kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore. Edhe pse këta tregues janë thelbësorë për vlerësimin e performancës, ata jo gjithmonë zbulojnë shkaqet themelore të sfidave që prekin gjyqësorin dhe as nuk pasqyrojnë plotësisht cilësinë e drejtësisë që u ofrohet qytetarëve.

Pikërisht këtu shërbimet e inspektimit gjyqësor luajnë një rol të pazëvendësueshëm. Brenda juridiksioneve tona përkatëse, strukturat e inspektimit ndihmojnë në identifikimin e mangësive sistemike, vonesave procedurale, sfidave organizative dhe rreziqeve institucionale që mund të cenojnë funksionimin e duhur të gjyqësorit.

Veçanërisht në vendet që po kalojnë reforma të thella në drejtësi, shërbimet e inspektimit mund të luajnë një rol jetik në garantimin e stabilitetit institucional, koherencës dhe vazhdimësisë së standardeve profesionale.

Njëkohësisht, ato kontribuojnë në mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit duke siguruar që mekanizmat e llogaridhënies të jenë të drejtë, objektivë dhe në përputhje me standardet evropiane. Për RESIJ, ruajtja e këtij ekuilibri ndërmjet llogaridhënies dhe pavarësisë mbetet një prioritet themelor.

Misioni ynë shkon përtej monitorimit të performancës. Ai synon të promovojë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm institucional, të mbështetur në profesionalizëm, transparencë dhe besim publik. Zgjerimi dhe konsolidimi i vazhdueshëm i Rrjetit tonë pasqyron rëndësinë në rritje të këtij misioni.

Këtu e përfundoj prezantimin tim dhe kërkesën zyrtare për aplikimin RESIJ, si dhe ju uroj punë të mbarë në vazhdim.

Faleminderit.



## QERSHORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Qershor 2026** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **163 ankesa**, nga të cilat 160 janë **depozituar nga qytetarë** dhe 3 ankesa nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Qershor 2026**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR	INSPEKTIME
<p><b>79 vendime nga 154 praktika të trajtuara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 55 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar</li><li>- 24 vendime arkivimi pas verifikimit</li></ul>	<p><b>25 vendime verifikimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"><li>- <b>1 vendim për përfundim hetimi disiplinor</b> për 1 magjistrat (Anëtar i KLP)</li><li>- <b>1 kërkesë për procedim disiplinor</b> për 1 magjistrat (Anëtar i KLP)</li></ul>	<p><b>1 inspektim i përfunduar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, për periudhën 1 janar 2024 – 31 dhjetor 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.”</li></ul>

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

## RUBRIKA/ PRAKTIKANTËT FLASIN!



**Annabell Cupi** është një juriste e re e talentuar, e lindur dhe e rritur në Londër, Mbretëri e Bashkuar, me origjinë familjare nga Burreli. Ajo ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera (“Distinction”) studimet pasuniversitare juridike dhe Masterin pranë Inns of Court College of Advocacy dhe University of Law në Londër. Së shpejti, Annabella pritet të thirret zyrtarisht në Barin e Anglisë dhe Uellsit nga Honourable Society of the Middle Temple, duke u kualifikuar si barrister, një formë avokatie e specializuar me të drejtë të plotë përfaqësimi dhe paraqitjeje përpara gjykatave britanike. Përmes këtij angazhimi, Annabella synon të kontribuojë në forcimin e lidhjeve ndërmjet diasporës dhe zhvillimit ligjor e institucional të Shqipërisë. Së fundmi, si pjesë e këtij misioni, ajo ka përfunduar me sukses një praktikë intensive 3-javore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Kjo eksperiencë i dha asaj një njohje të thellë të proceseve të llogaridhënies dhe reformës në drejtësi në Shqipëri, duke shërbyer si një urë e rëndësishme bashkëpunimi dhe shkëmbimi të ekspertizës ligjore britanike me institucionet vendase. Por, Annabell tregon më shumë mbi këtë përvojë përmes pyetjeve të mëposhtme.

### 1. Çfarë ju shtyu të zgjidhnit Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të zhvilluar praktikën?

Interesi im për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u zhvillua përmes angazhimit tim më të gjerë me sistemin e drejtësisë në Shqipëri dhe procesin e reformës në drejtësi. Më 24 shkurt 2024, British Albanian Laëyers Association organizoi një aktivitet në Ambasadën e Shqipërisë në Londër, ku i ftuar kryesor ishte Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani.

Përpara këtij aktiviteti, unë kisha nisur të thelloja njohuritë e mia mbi sistemin gjyqësor shqiptar, duke marrë pjesë në aktivitete të tilla si “Strengthening the Albanian Justice System Enhancing UK-Albanian Cooperation, Best Practices and Vetting in Judicial Reform”, ku u zhvilluan diskutime me përfaqësues të lartë të gjyqësorit shqiptar, përfshirë përfaqësues nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit dhe Gjykatat Administrative. Aktiviteti me z. Metani ishte veçanërisht mbresëlënës. Ai trajtoi një sërë çështjesh që lidhen me punën e institucionit, përfshirë shqyrtimin e ankesave, hetimin dhe procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, inspektimet në gjykata dhe prokurori, si dhe çështje më të gjera që lidhen me pavarësinë e magjistratëve dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Më bëri shumë përshtypje qartësia, qetësia dhe profesionalizmi me të cilin ai iu përgjigj pyetjeve komplekse. Ky aktivitet më prezantoi me një institucion që, megjithëse relativisht i ri brenda kuadrit të reformës në drejtësi, luan një rol thelbësor në forcimin e llogaridhënies gjyqësore, pavarësisë institucionale dhe mbrojtjes së integritetit të sistemit të drejtësisë. Pas bisedës me z. Metani dhe pas leximit të botimit “Historia e Përgjithshme e Procesit Disiplinor ndaj Magjistratëve në Shqipëri (1912–2025)”, u nxit të aplikoj për praktikë. Zgjedha të zhvilloj një periudhë më të gjatë praktike pranë Zyrës, me qëllim që të fitoja një kuptim më të thelluar mbi institucionin dhe rolin e tij në sistemin ligjor shqiptar.

## 2. Cila ishte përshtypja juaj e parë kur nisët praktikën?

Përshtypja ime e parë kur nisa praktikën ishte se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një institucion shumë profesional dhe me rëndësi të veçantë. Që në fillim ishte e qartë për mua se puna e këtij institucioni luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë dhe në forcimin e llogaridhënies brenda pushtetit gjyqësor. Duke qenë se kam studiuar drejtësi në Mbretërinë e Bashkuar, më dukej veçanërisht interesante të shihja se si parime të tilla si pavarësia gjyqësore, llogaridhënia dhe mbikëqyrja institucionale zbatohen në praktikë brenda sistemit ligjor shqiptar. Isha veçanërisht e interesuar të kuptoja rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në shqyrtimin e ankesave, vlerësimin e çështjeve disiplinore dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Njëkohësisht, u ndjeva shumë e mirëpritur nga stafi. Mjedisi i punës ishte profesional, i strukturuar dhe mbështetës, gjë që më mundësoi të bëja pyetje, të mësoja nga personat përreth meje dhe të kisha një kuptim më të qartë të punës së përditshme të institucionit.

## 3. A pati ndonjë moment apo detyrë që ju bëri më shumë përshtypje?

Dy aspekte të praktikës më lanë përshtypje të veçantë: njohja me kuadrin ligjor dhe më pas mundësia për të parë se si ky kuadër zbatohet në praktikë. Në fillim të praktikës, Drejtoria e Shërbimeve Juridike më ofroi një shpjegim hyrës mbi sistemin ligjor shqiptar, përfshirë bazat e tij në të drejtën civile, strukturën kushtetuese dhe kuadrin ligjor specifik që rregullon veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Duke qenë se formimi im juridik është zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar, në një sistem të së drejtës zakonore, ishte jashtëzakonisht interesante të krahasoja dy traditat ligjore dhe të kuptoja mënyrën se si legjislacioni shqiptar, veçanërisht ligji nr. 96/2016, rregullon procesin disiplinor ndaj magjistratëve. Një tjetër aspekt mbresëlënës ishte vëzhgimi i takimeve me qytetarët. Disa prej tyre i drejtoreshin institucionit për herë të parë dhe nuk kishin një kuptim të plotë të procesit të ankesës, ndërsa të tjerë kërkonin informacion mbi fazën apo ecurinë e ankesës së tyre. Ishte shumë e vlefshme të shihja mënyrën se si institucioni komunikon me qytetarët që shpesh mund të ndihen të shqetësuar, të pasigurt ose të frustruar për situatën e tyre. Ajo që më bëri përshtypje ishte qasja e qetë, e respektueshme dhe profesionale me të cilën qytetarët asistoheshin. Ky proces më tregoi se rëndësi nuk ka vetëm saktësia ligjore, por edhe komunikimi i qartë, durimi dhe aksesueshmëria në marrëdhënien me publikun. Gjithashtu, pata mundësinë të shihja rëndësinë e afateve procedurale në praktikë. Për shembull, ankesa konfirmohet brenda 5 ditëve, vendimi për arkivim ose fillim hetimi merret brenda afateve të përcaktuara nga ligji, ndërsa hetimi duhet të përfundojë brenda 6 muajve, me mundësi zgjatjeje në rrethana të caktuara. Vëzhgimi i këtyre elementeve në praktikë më ndihmoi të kuptoj se si institucioni ndërthur procedurën ligjore me efikasitetin, profesionalizmin dhe llogaridhënien.

## 4. Çfarë do të merrni me vete nga kjo eksperiencë?

Nga kjo eksperiencë do të marr me vete një kuptim shumë më të thelluar të rolit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Tani e kuptoj më qartë se si shqyrtohen ankesat, si vlerësohet pranueshmëria e tyre, si mund të hapet një hetim dhe sesi mbikëqyrja disiplinore kontribuon në integritetin dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, përfitova një vlerësim më të qartë për rëndësinë e pavarësisë institucionale. Puna e Zyrës nuk është vetëm ligjore dhe procedurale, por lidhet ngushtë edhe me ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Kjo eksperiencë më ndihmoi të kuptoj se mekanizmat e llogaridhënies janë thelbësore për funksionimin e duhur të institucioneve të drejtësisë dhe për ruajtjen e besimit të qytetarëve tek ato. Në aspektin personal, kjo praktikë e ka forcuar edhe më shumë interesin tim për drejtësinë, shërbimin publik dhe sistemet ligjore krahasuese. Ajo më dha mundësinë të lidh formimin tim juridik në Mbretërinë e Bashkuar me interesin tim për zhvillimin ligjor dhe reformën në drejtësi në Shqipëri.

## 5. Çfarë keni mësuar gjatë qëndrimit në ILD, që nuk e kishit njohur më parë?

Gjatë qëndrimit tim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kam mësuar shumë mbi kuadrin disiplinor për magjistratët në Shqipëri, veçanërisht mbi bazën ligjore për shqyrtimin e ankesave, vlerësimin e pranueshmërisë së tyre, hapjen e hetimeve dhe respektimin e afateve procedurale. Një nga gjërat më të rëndësishme që mësova ishte se sa me kujdes duhet të vlerësohet nëse një ankesë mund të vijojë më tej. Kjo përfshin analizën nëse ankesa është brenda afatit të parashkrimit, nëse lidhet me një magjistrat që ka qenë në detyrë në momentin e pretenduar, nëse sjellja e pretenduar mund të përbëjë shkelje disiplinore dhe nëse ekziston një bazë ligjore për verifikim ose hetim të mëtejshëm. Gjithashtu, mësova më shumë mbi rëndësinë praktike të komunikimit me qytetarët. Duke ardhur nga një formim dhe eksperiencë në fushën penale në Mbretërinë e Bashkuar, shpesh kam vëzhguar procedime nga këndvështrimi i prokurorisë, mbrojtjes dhe gjykatës. Në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pata mundësinë të shoh një dimension tjetër të sistemit të drejtësisë: individë që ndihen se diçka në çështjen e tyre mund të mos jetë trajtuar siç duhet dhe që kërkojnë sqarim, udhëzim ose llogaridhënie. Kjo më bëri të reflektoj edhe mbi praktikën time të ardhshme profesionale, teksa synoj të nis karrierën në Bar, veçanërisht në fushën e ndjekjes penale. Më kujtoi se sa e rëndësishme është të komunikohet qartë me qytetarët, të shmangen keqkuptimet dhe të sigurohet që personat të ndihen të dëgjuar dhe të trajtuar me respekt.

**6. Si do ta përshkruanit me pak fjalë atmosferën e punës në institucion?**

Atmosferën e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do ta përshkruaja si profesionale, të strukturuar dhe mbështetëse. Që në fillim të praktikës vura re se stafi e trajtonte punën me seriozitet dhe përkushtim, gjë që është e domosdoshme duke pasur parasysh rolin e institucionit në llogaridhënien gjyqësore, integritetin dhe besimin e publikut. Puna që kryhet nga Zyra kërkon vëmendje ndaj detajeve, saktësi ligjore dhe një ndjenjë të lartë përgjegjësie institucionale. Njëkohësisht, ambienti ishte mikpritës dhe inkurajues. U ndjeva e lirë të bëja pyetje, të vëzhgoja aspekte të ndryshme të punës së institucionit dhe të mësoja nga personat përreth meje. Ky kombinim ndërmjet profesionalizmit dhe mbështetjes e bëri eksperiencën jashtëzakonisht të vlefshme.

**7. Çfarë mesazhi do t'u jepnit studentëve të tjerë, ose të rinjve që dëshirojnë të ndjekin një praktikë profesionale në institucionet e drejtësisë, apo në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë?**

Mesazhi im për studentët dhe të rinjtë e tjerë do të ishte që të shfrytëzojnë çdo mundësi për të fituar eksperiencë praktike brenda institucioneve të drejtësisë. Këto eksperiencë të ndihmojnë ta kuptosh ligjin përtej librave dhe studimeve akademike, duke parë se si parimet ligjore zbatohen në praktikë. Një praktikë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ofron një mundësi shumë të vlefshme për të kuptuar më mirë mbikëqyrjen gjyqësore, llogaridhënien dhe pavarësinë institucionale. Do t'i inkurajoja studentët të jenë kureshtarë, të bëjnë pyetje dhe të përfitojnë sa më shumë nga mundësia për të vëzhguar punën e rëndësishme që kryhet. Edhe një praktikë e shkurtër mund të të mësojë shumë mbi përgjegjësinë e institucioneve ligjore dhe rëndësinë e ruajtjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Për mua, kjo eksperiencë ka qenë shumë edukative dhe domethënëse, dhe do t'ia rekomandoja çdo të riu që është i interesuar për ligjin, drejtësinë dhe shërbimin publik.



## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR



### *Gjatë asistimit të ankuesve*


Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Qershor 2026**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **8 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit [elis.kuci@ild.al](mailto:elis.kuci@ild.al)

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Qershor 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **10 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Zyrtare: RESIJ është tashmë pjesë e familjes CEPEJ. I nderuar që pata mundësinë të paraqes në emër të RESIJ kërkesën për marrjen e statusit të vëzhguesit në Asamblenë e 46-të Plenare të CEPEJ. Kërkesa u miratua unanimisht duke shënuar një arritje të rëndësishme për Rrjetin tonë.



**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇩🇪

- ✅ 9335 të konfirmuara
- ✅ 6966 të trajtuara
- ✅ 2369 në proces trajtimi
- ✅ 194 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 55 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉👈  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)

9,335+	6,966	2,369	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the course process	Investigated magistrates
		194	55
		Complaints in the verification process after the initial review	Requests for disciplinary proceedings

This information is updated every monday

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇩🇪

- ✅ 9214 të konfirmuara
- ✅ 6907 të trajtuara
- ✅ 2307 në proces trajtimi
- ✅ 194 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 54 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉👈  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)

9,214+	6,907	2,307	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the course process	Investigated magistrates
		194	54
		Complaints in the verification process after the initial review	Requests for disciplinary proceedings

This information is updated every monday

**Thematic and Institutional Inspections**

THIS MONTH: 31      COMPLETED: 19

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Metani:Nëse do të gjykojmë një ditë suksesin e reformës në drejtësi treguesi më domethënës nuk do të jetë thjesht numri i çështjeve të trajtuara nga organet e vettingut, apo vendimet individuale të marra prej tyre por aftësia e institucioneve të reja...



From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇩🇪

- ✅ 9288 të konfirmuara
- ✅ 6942 të trajtuara
- ✅ 2346 në proces trajtimi
- ✅ 195 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 55 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉👈  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)

9,288+	6,942	2,346	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the course process	Investigated magistrates
		195	55
		Complaints in the verification process after the initial review	Requests for disciplinary proceedings

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

I mandatuar nga Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë për të paraqitur zyrtarisht aplikimin për marrjen e statusit të vëzhguesit pranë CEPEJ, Metani iu drejtua Asamblesë duke vënë në pah kontributin e Rrjetit për inspektimin e drejtësisë



From ild.al

## QERSHOR 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara  
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

## KONTAKT

Web: [ild.al](http://ild.al)  
Tel: +35542217217  
Email: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!